



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA**

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology**

**PLAN STRATEGJIK PËR ORGANIZIMIN E ARSIMIT
GJITHPËRFSHIRËS TË FËMIJEVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE NE ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË
2010 - 2015**

Prishtinë, MARS 2010

PËRMBAJTJE

SHKURTESAT	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
HYRJE.....	4
ANALIZË DHE PREZANTIM I KONTEKSTIT	6
VIZIONI I PLANIT STRATEGJIK	8
QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK TË VEPRIMIT	8
OBJEKTIVAT DHE MUNDËSITË E REALIZIMIT	9
FJALOR TERMINOLOGJIK.....	20
REFERENCA.....	23

FALENDERIM

Grupi i punës falënderon për kontributin e dhënë gjatë hartimit të këtij plani strategjik të gjithë pjesëmarrësit në punëtoritë e zhvilluara për hartimin e këtij dokumenti, si dhe pjesëmarrësit në diskutimet publike të zhvilluara në shtatë qendrat më të mëdha rajonale të Kosovës.

SHKURTESAT

AGJ	Arsim gjithëpërfshirës
BB	Banka Botërore
BKK	Buxheti i konsoliduar i Kosovës
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
DKSH	Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë
DSK	Down Syndrome Kosova
EMIS	Zyra e statistikave në MASHT
EVM	Ekipe vlerësuese dhe mbështetëse
MIUJ	Mbështetja Institucionale e Universitetit Jyväskylä për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në Kosovë 2009-2010
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
IP	Institucione parashkollore
PIA	Plani Individual i Arsimit
FE	Fakulteti i Edukimit
KAA	Komunikimi alternativ dhe augmentativ
KPA	Këshilli Prindër-Arsimtarë
KPAK	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPMS	Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
QAP	Qendra e aftësimin profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
QB	Qendra burimore
TESFA	Drejt një Shkolle Efektive për të Gjithë
SHPA	Shoqatat Prindër-Arsimtarë
UNICEF	Fondi Emergjent Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UP	Universiteti i Prishtinës
USHPAK	Unioni i Shoqatave Prindër –Arsimtarë të Kosovës
ZKM	Zyra për Qeverisje të mirë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

"E dimë se bota është komunitet gjithëpërfshirës. Është shumë e rëndësishme për fëmijët që të kenë mundësinë të mësojnë dhe të rriten brenda komuniteteve të cilat paraqesin botën në të cilën ata do të jetojnë pasi që ta mbarojnë shkollën e mesme."

Mara Sapon-Shevin

Bazuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011, me iniciative të shoqatës Down Syndrome Kosova¹ dhe në vazhdimësi të aktiviteteve të parapara në strategjitë e zhvillimit të arsimit, pjesë e politikës shtetërore 'Arsimim për të gjithë' dhe në bashkëpunim të ngushtë me universitetin Jyväskylä², Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, filloi procesin e hartimit të strategjisë kombëtare për mbështetjen dhe funksionalizimin e mëtejme të procesit të gjithëpërfshirjes në shkolla, për periudhën 2010-2015.

Kjo strategji reflekton bashkëpunimin e ngushtë dhe konsensusin e shumë partnerëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të këtij procesi qoftë në nivelin qendror e lokal të shoqërisë civile, të organizatave profesionale. Dokumenti strategjik ka përmbledhur në vetvete të gjitha shqetësimet dhe sfidat që e shoqërojnë këtë proces, duke përcaktuar vizionin dhe qëllimin e tij dhe objektivat strategjike si: Identifikimi dhe intervenimi i hershëm dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore; Sigurimi dhe përforcimi i mekanizmave mbështetës për shkollat gjithëpërfshirëse; Zhvillimi profesional i personelit edukativo-arsimor; Përmirësimi i infrastrukturës fizike për shkollën gjithëpërfshirëse dhe Ngritja e vetëdijes gjithëpërfshirëse. Njëkohësisht ofrohen ide dhe aktivitete konkrete për realizimin e këtyre objektivave.

Krijimi i një komuniteti arsimor gjithëpërfshirës, është detyrë e secilit anëtar të shoqërisë, si rrjedhim mbetet përgjegjësi e secilit prej nesh të japë kontributin e tij maksimal në realizimin e aktiviteteve të parapara, duke qenë të bindur se është shoqëria ajo që përfiton më tepër nga kjo.

¹ MASHT & Down Syndrome Kosova- Memorandum bashkëpunimi (Iniciative avokuese për Edukimin e Hershem dhe Arsimin Gjithëpërfshirës.

² MEST & JU., (2009). *Memorandum of Understanding regarding the Institutional Support of JU to MEST in Kosovo 2009-2010.*

HYRJE

Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është një sfidë për të gjitha vendet që synojnë të realizojnë parimin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët pa dallim feje, kulture, race gjinie e diversiteti e që është e drejtë themelore e çdo njeriu.

Në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme, gjithëpërfshirja është bërë tashmë një realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë problematikë po ballafaqohet edhe Kosova, e cila po bënë përpjekje në drejtim të realizimit të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës.

Shndërrimet e shumta që ndodhën në vendin tonë viteve të fundit, patën ndikime të fuqishme edhe në fushën e arsimit me aplikimin e reformave në të gjitha nivelet e arsimit dhe kjo ka sjellë edhe nocione dhe koncepte të reja në trajtimin dhe vendin që duhet të zë arsimit special. Në këtë periudhë, kontribut të çmuar ka dhënë Përkrahja Finlandeze për Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë (FSDEK)³, sidomos në hartimin e politikave për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, trajnimin e ekspertëve, mësimdhënësve etj. Me gjithë arritjet e shënuara në disa fusha ende ka shumë aspekte ku duhet të punohet në mënyrë që të sigurohet gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Në themel të procesit të gjithëpërfshirjes qëndron një grup i tërë parimesh që sigurojnë që fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të shihen si anëtarë të vlefshëm të komunitetit shkollor në çdo aspekt të tij. Andaj shkollat gjithëpërfshirëse marrin për bazë se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të qëndrojnë bashkë në një klasë, afër vendbanimit të tyre. Mundësitë që i ofrohen fëmijës nuk duhet të bazohen në vlerësimin e aftësisë së kufizuar, por në nevojat individuale të fëmijës, të gjithë mësuesit pa përjashtim mund të mësojnë të gjithë fëmijët.

Kërkesa të tilla shtrojnë nevojën e punës së madhe që duhet të bëhet që nga institucionet vendimmarrëse e deri te shkolla në mënyrë që ato të jenë në gjendje për të marrë një rol të tillë, i cili është shumë sfidues. Për të përmbushur një mision të tillë, MASHT është duke punuar në drejtim të krijimit të infrastrukturës ligjore, e cila do të mundësojë arsimin e të gjithë fëmijëve dhe sigurimin e një ambienti të hapur ndaj ndryshueshmërie.

Synimi ynë është që shkollat të promovojnë një ambient miqësor për fëmijët sepse kushtet materiale sado të mira të jenë nuk do të thotë që sigurojnë ngrohtësi për fëmijët e tjerë që për arsye të ndryshme janë jashtë shkollës.

Këto dhe shumë aspekte tjera tregojnë se duhet të punojmë në disa drejtime për t'i adresuar problemet që kemi për të realizuar arsimin gjithëpërfshirës për vetë faktin që pjesa më e madhe e fëmijëve me nevoja të veçanta nuk janë të përfshirë në shkollë, por

³ Raportet vlerësuese të FSDEK-ut

edhe atyre fëmijë që janë në sistem, t'ju ofrohet arsim cilësor, i cili bazohet në nevojat individuale të fëmijëve.

Me gjithë përpjekjet e bëra ende mbetet shumë për tu bërë në mënyrë që të arrijmë përmirësimin e situatës së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, gjë e cila duhet të jetë preokupimi i tërë shoqërisë.

Andaj, që të ketë efektivitet procesi gjithëpërfshirës dhe rezultatet të jenë të dukshme, duhet punuar në ndryshimin e shkollës, në mënyrë që të krijojmë një shkollë me një koncept të ri që të jetë e hapur dhe që promovon gjithëpërfshirje, barazi dhe qasje për të gjithë fëmijët.

ANALIZË DHE PREZANTIM I KONTEKSTIT

Arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë funksionon nga viti 1950 dhe deri në vitet e 80-ta, përmes ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve kanë funksionuar disa shkolla speciale në të cilat zhvillohej mësimi fillor dhe i mesëm.

Mësimi ofrohej për një numër të kufizuar të fëmijëve dhe nuk ishte cilësor për arsye të mungesës së kuadrove profesionale jo të përgatitura për të punuar me këta fëmijë. Kapaciteti i kufizuar i shkollave speciale ndikonte në përfshirjen në numër të vogël të fëmijëve të cilët ishin kryesisht të vendeve urbane, duke i përjashtuar fëmijët që vinin nga vendet rurale.

Në vitet e 90-ta arsimi kosovar u gjend në rrethana të jashtëzakonshme duke punuar në një sistem paralel, pjesë e të cilit ishte edhe arsimi special. Në këtë periudhë funksiononin katër shkolla speciale dhe katër klasë të bashkangjitura në kuadër të shkollave të rregullta. Ishin të përfshirë vetëm 400 fëmijë me lloje të ndryshme të dëmtimeve⁴. Kjo gjendje e vështirë në të cilin gjendej arsimi kosovar, vazhdoi deri në përfundim të luftës së vitit 1999, vit ky që shënon ndryshimet e para. Këto ndryshime u reflektuan në tërë sistemin e arsimit dhe në arsimin special gjithashtu.

Në këtë kohë shumë agjenci u angazhuan për të ndihmuar reformat në arsimin kosovar dhe në këtë kuadër përfitoi edhe arsimi special, pasi që në këtë kohë agjenci udhëheqëse për arsimin special u caktua qeveria e Finlandës: Përkrahja Finlandeze për Zhvillimin e Arsimit Special në Kosovë, FSDEK. Kjo agjenci ka punuar në ngritjen e kapaciteteve vendase për arsimin special në të gjitha segmentet, gjë që ndikoi edhe në rritjen e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë organizohet në institucione parashkollore, shkolla speciale / qendra burimore, klasë të rregullta dhe klasë të bashkëngjitura, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave të rregullta dhe në tre shkolla ku janë të punësuar arsimtarë gjithëpërfshirës. Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, viteve të fundit ka shënuar rritje, kështu vetëm në vitin shkollor 2009/2010 numri i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore që marrin mbështetje dhe që janë përfshirë në shkolla ka shënuar rritje prej 30% pra nga 909 fëmijë në vitin shkollor 2008-2009, ka arritur në 1179 fëmijë⁵.

Sistemi aktual i arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore gjithnjë e më tepër po shkon drejt hapjes ndaj arsimit të rregullt, me qëllim që fëmijët me nevoja të veçanta arsimore gjithnjë e më tepër të jenë pjesë e shkollave dhe klasave të rregullta. Viteve të fundit është punuar në ngritjen e kapaciteteve të qendrave burimore në mënyrë që ato të ofrojnë shërbime profesionale për shkollat e rregullta.

⁴FSDEK (2003). Edukimi Special në Kosovë. GME. f.24.

⁵ MASHT – Njësia për arsim special (2009-2010)

Në kuadër të funksionalizimit në të gjitha qendrat burimore janë formuar ekipet bërthamë në nivel të qendrave me qëllim të krijimit të sistemit të mbështetjes profesionale për mësimdhënësit dhe fëmijët me nevoja të veçanta arsimore që janë në shkolla të rregullta. Në kuadër të këtij sistemi mbështetës janë punësuar mësimdhënës udhëtues të cilët mbështesin fëmijët me nevoja të veçanta arsimore që janë në shkolla të rregullta. Në periudhën kohore 2009/2010, 103 fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta janë mbështetur nga qendrat burimore nëpërmjet të mësimdhënësve udhëtues⁶.

Klasat e bashkangjitura aktualisht akomodojnë përafërsisht 50% të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe numri i tyre është 73 klasë në gjithë vendin⁷. Klasat e bashkangjitura janë shumë heterogjene për nga mosha dhe lloji i dëmtimit të fëmijëve, prandaj edhe nevojat e tyre për ofrim të arsimit special janë të larmishme.

Gjatë këtyre viteve vazhdimisht është punuar në drejtim të gjithëpërfshirës dhe në këtë aspekt mund ti referohemi projektit të organizatës 'Save The Children' me institucionet parashkollore në komunën e Gjilanit dhe Pejës, projekt i cili është treguar i suksesshëm, si dhe programi i Edukimit dhe Intervenimit të Hershem (PEIH) të organizatës Down Syndrome Kosova, program i cili fokusohet në edukimin e prindërve të komunitetit me sindromin Down dhe përgatitjen e fëmijëve për sistemin arsimor duke arritur të regjistroj tetëmbëdhjetë (18) fëmijë në dy nivelet e sistemit të arsimit parashkollor dhe fillor në Kosovë⁸.

Në vitin shkollor 2009-2010 MASHT në bashkëpunim me projektin Finlandës Mbështetja Institucionale e Universitetit Jyväskylä për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë 2009-2010 janë duke punuar në ndryshimin e 3 shkollave të rregullta në shkolla gjithëpërfshirëse, e cila krijon një mundësi të mirë që ky model të provohet në praktikë, në mënyrë që në të ardhmen fëmijët me nevoja të veçanta arsimore të arsimohen në shkolla të rregullta me bashkëmohatarët e tyre.

Me gjithë të arriturat e shënuara, për MASHT-in mbeten shumë sfida sa i përket arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, si: rritja e numrit të fëmijëve të përfshirë në sistemin arsimor; në edukimin parashkollor dhe parafillor i cili është bazë për arsimin e mëtejshëm, arsimit mesëm i lartë, i cili po ashtu kërkon përpjekje që të aftësojmë të rinjtë me nevoja të veçanta për tregun e punës dhe jetë të pavarur.

⁶ MASHT – Njësia për arsim special (2009-2010)

⁷ MASHT – EMIS (2010). Statistikat e arsimit në Kosovë 2009-2010.

⁸ DSK- Sistemi I të dhënave dhe statistikave (2009)

VIZIONI I PLANIT STRATEGJIK

Duke marrë gjithësi në konsideratë domethënien e përcaktimit nga UNESCO (2001) për arsimin gjithëpërfshirës i cili nënkupton që "...të gjitha shkollat duhet të pranojnë të gjithë fëmijët pa marrë parasysh gjendjen e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose ndonjë gjendje tjetër. Kjo duhet të përfshijë fëmijët me aftësi të kufizuara arsimore dhe fëmijët me talent, fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë, fëmijët nga viset e larta dhe popullatat nomade, fëmijët e minoriteteve gjuhësore, etnike ose kulturore dhe fëmijët nga viset apo grupet e marginalizuara", por gjithashtu edhe duke pasur parasysh vizionin e shprehur në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2007-2017, grupi hartues i këtij plani strategjik ka përcaktuar këtë vizion :

"Për një sistem arsimor cilësor për të gjithë fëmijët, duke marrë parasysh dhe respektuar nevojat individuale, interesat dhe mundësitë"

QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK TË VEPRIMIT

Ky plan strategjik veprimi përcakton në mënyrë të strukturuar dhe të integruar se si i duhet qasur dhe se si të trajtohet çështja e procesit të gjithëpërfshirjes, por në aspektin e saj më praktik dhe funksional.

Meqenëse respekton dhe mbështetet në disa nga dokumentet bazë, si Strategjia e Zhvillimit Parauniversitar (2007-2017), Synimet e Mileniumit, Ligjet që mbrojnë të drejtat e fëmijës (zbatimi i të cilave garanton gjithëpërfshirjen në arsim), Planin kombëtar të veprimit për personat me aftësi të kufizuara (2009), Strategjitë e ndryshme në arsim etj, qëllimi kryesor i këtij plani strategjik për veprim është ndikimi në nivelin më praktik në trajtimin e kësaj çështjeje, realizimin e aktiviteteve efektive, sigurimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit në të gjitha hallkat e shoqërisë, përputhshmërinë e tij me planifikimin buxhetor dhe korniza të tjera të zhvillimit në Kosovë dhe monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së zbatimit të tij, duke kontribuar në krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse në të cilën gjithsecili ka mundësi të plotësojë dhe shprehë kapacitetet e tij individuale në shërbim dhe për më të mirën e shoqërisë.

OBJEKTIVAT DHE MUNDËSITË E REALIZIMIT

Objektivat e planit strategjik janë vendosur brenda një kornize të vetme, e cila adreson:

- **Objektivat përkatëse**, realizimi i të cilave do të mundësojë krijimin e shkollave të gatshme për të pranuar të gjithë fëmijët.
- **Aktivitetet /veprimet specifike**, të cilat zërthejnë objektivin përkatës, duke bërë të mundur përmbushjen më me lehtësi dhe siguri të tyre
- **Bartësit kryesorë** përgjegjës për realizimin e aktiviteteve përkatëse
- **Partnerët** që do të ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve përkatëse
- **Afatin kohor** në të cilin do të zhvillohet aktiviteti
- **Burimin e buxhetit**, që pasqyron përkrahjen financiare për secilin veprim [financimi nga buxheti i Kosovës, buxhetet e Komunave apo përkrahja nga donatorët si dhe shumën e nevojshme]
- **Treguesit e aktiviteteve / indikatorët**, përmes të cilëve do të matet edhe realizueshmëria dhe vlerësimi i saj
- **Mekanizmat e vlerësimit**, të cilët do të jenë përgjegjës për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të realizimit të aktiviteteve dhe si rrjedhim të objektivave të përcaktuar

Objektivat e përcaktuara janë:

- Objektiva I: Identifikimi dhe intervenimi i hershëm dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore**
- Objektiva II: Sigurimi dhe përforcimi i mekanizmave mbështetës për shkolla gjithëpërfshirëse**
- Objektiva III: Zhvillimi profesional i personelit edukativo-arsimor për arsim gjithëpërfshirës**
- Objektiva IV: Përmirësimi i infrastrukturës fizike për shkollën gjithëpërfshirëse**
- Objektiva V: Ngritja e vetëdijes gjithëpërfshirëse**

Buxhetimi i këtij plani ka respektuar kornizën buxhetore të Ministrisë së Arsimit, dhe mundësitë e planifikimeve vjetore të komunave. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara dhe për të cilat është referuar si burim kryesor MASHT, ka domethënie që ato aktivitete janë pjesë e veprimtarisë së planifikuar dhe buxhetuar nga Ministria, ndërkohë që për të gjitha aktivitetet në të cilat është shënuar edhe burim tjetër, këto fonde duhet të sigurohen nga burimet përkatëse të cekura në secilin aktivitet.

OBJEKTIVI 1 : ===== Hapat e veprimeve:	IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMI I HERSHËM DHE RRRITJA E PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE					
	Institucioni organizata përgjegjës	Partnerët	Afatet Kohore	Burimet e financimit	Tregues [Indikatorët]	Mekanizmat e vlerësimit
Krijimi i mekanizmave ndërsektorial për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore	MASHT MSH MPMS	MASHT MPMS MSH QPS, OJQ Prindërit	Shtator 2010 Proces	BKK 11.350 €	*Rrjeti funksional *Numri i fëmijëve të identifikuar	ZKM
Krijimi dhe funksionalizmi i Ekipeve Vlerësuese dhe Mbështetëse (EVM) në komuna	MASHT DKA	Komuna	Shtator 2010	MASHT Komuna 11.350 €	*Ekipet e krijuara *Numri i fëmijëve të vlerësuar	MASHT
Krijimi i programit specifik për intervenim dhe edukim të hershëm	MSH MASHT MPMS	Institucionet shëndetësore Këshillimoret IP	2010 në vazhdim	MSH MASHT MPMS 42.524 €	Programet e krijuara dhe funksionale	MSH MASHT MPMS Prindërit
Fushata mediale mbi rëndësinë e identifikimit dhe intervenimit të hershëm	MASHT	OJQ Prindërit Komunat	Mars-Qershor 2011	MASHT UNICEF Donatorë OJQ 39.000 €	Numri i emisioneve në media, broshura dhe artikuj të ndryshëm	MASHT
Hartimi i udhëzimeve administrative (UA) dhe akteve nënligjore që	MASHT		Prill 2010 - 2015	MASHT	Numri i akteve nënligjore UA për EVM	MASHT

dalin si kërkese nga ligji i rishikuar				28.000 €	PIA-n	
Monitorimi i zbatimit të ligjeve, akteve nënligjore dhe UA	MASHT (inspektorët rajnonal) DKA, DKSH	DKA Shoqëria civile	Shtator 2010 - 2015	MASHT	Raporti i progresit mbi monitorimin	MASHT DKA

OBJEKTIVI 2: =====	SIGURIMI DHE PERFORCIMI I MEKANIZMAVE MBESHTETES PER SHKOLLA GJITHEPERFSHIRESE					
	Institucioni organizata përgjegjëse	Partnerët	Afatet Kohore	Burimet e financimit	Treguesit [Indikatorët]	Mekanizmat e vlerësimit
Funksionalizmi i Qendrave Burimore (QB)	MASHT	DKA Shkollat IP	2010 - 2013	MASHT DKA 529.840 €	Numri i fëmijëve të përkrahur me shërbime profesionale dhe materiale ndihmëse	Grupi bërthamë brenda Qendrës MASHT DKA
Sigurimi i asistentëve bazuar në nevojat e fëmijëve	MASHT DKA	Agjensionet KPAK	Gusht- 2010	MASHT 120.000 €	Numri i asistentëve të pranuar	MASHT,DKA, OJQ
Rritja e numrit të mësimdhënësve gjithëpërfshirës bazuar në nevoja	MASHT DKA	Agjensionet	Gusht 2010	MASHT 1.296.000 €	Numri i mësimdhënësve të pranuar	MASHT,DKA. Ekspert të jashtëm
Rritja e numrit të shkollave gjithëpërfshirëse	MASHT DKA	KPAK	2010-2015	DKA MASHT Donatorët 817.020 €	Numri i shkollave gjithëpërfshirëse	DKA MASHT
Sigurimi i transportit dhe mjeteve të punës për mësuesit udhëtues	MASHT	MASHT	proces	MASHT	Transporti funksional dhe qasja në mjetet e punës	MASHT,QB
Hartimi i normativave për standardet për arsimin gjithëpërfshirës	MASHT	DKA OJQ Donatorë Shkollat	2010 2011	MASHT Donatorë	Dokumentet normative të përfunduara	MASHT DKA
Implementimi i	DKA	OJQ	2010-2011	DKA	Rritja e numrit të	MASHT

Indeksit për gjithëpërfshirje në IP dhe shkolla	MASHT	Donatorë		Donatorë 203.290 €	shkollave gjithëpërfshirëse	DKA
Pilotimi i zbatimit të PIA-s	MASHT DKA	Prindërit Shkollat Ekspertët	2010 në vazhdim	DKA 6.180 €	Numri i PIA të hartuara dhe zbatuara	MASHT DKA
Organizimi i trajnimeve për zbatimin e PIA-s në të gjitha nivelet e arsimit	MASHT	UNICEF FE MIUJ IPK Save the Children TESFA	Shtator 2011 2015	UNICEF FE MIUJ IPK Save the Children TESFA, MASHT 6.048 €	Numri i trajnimeve të zhvilluara	UNICEF FE MIUJ IPK Save the Children TESFA, MASHT
Zbatimi i PIA në të gjitha nivelet e arsimit	MASHT DKA Shkollat IP	OJQ KPA SHPA	Janar 2012	MASHT, DKA 10.000 €	Numri i PIA të zbatuara	MASHT, DKA,IEA,IPK
Shndërrimi i Klasave të Bashkangjitura në Dhoma Burimore dhe funksionalizimi i tyre	MASHT DKA	OJQ Donatorë	2010-2011	MASHT 751.809 €	Numri i dhomave burimore të transformuara dhe funksionale	MASHT
Krijimi i rrjetit të mësimdhënësve gjithëpërfshirës	MASHT DKA	Shkollat, IP	2010	MASHT	Rrjeti i krijuar dhe funksional	MASHT
Identifikimi i nevojave dhe punësimi i interpretëve dhe instruktorëve të gjuhës së shenjave	MASHT	OJQ	2010	MASHT 144.000 €	Numri i të punësuarve	MASHT
Krijimi i kushteve për studime në UP për studentë me nevoja të veçanta arsimore	MASHT UP	UP	2010 në vazhdimësi	UP MASHT	Numri i studentëve të pranuar	MASHT

Ofrimi i programeve arsimore për personat me nevoja të veçanta arsimore mbi moshën shkollore	MASHT DKA	Donatorë QAP Shkollat MPMS	2010 në vazhdimësi	MASHT DKA 910.438 €	Numri i personave të përfshirë në programet e ofruara	MASHT DKA
Analiza sistematike e situatës dhe identifikimi i nevojave	MASHT DKA	Shkollat IP	2010-2014	MASHT 50.000 €	Numri i hulumtimeve, Aktivitet e realizuara dhe sugjerimet	MASHT
Formimi i Grupit për monitorimin e zbatimit të dokumentit të strategjisë për Arsim Gjithëpërfshirës	MASHT	DKA	2010-2014	MASHT 450 €	*Grupi i formuar *Raportet nga procesi i monitorimit të zbatimit	MASHT
Botimi i Revistës, librave dhe përkthimi i titujve me interes per Arsim Gjithëpërfshirës	MASHT	MASHT Donatoret OJQ	2010-2014	MASHT 20.000 €	Numri i botimeve	MASHT

OBJEKTIVI 3 : =====	ZHVILLIMI PROFESIONAL I PERSONELIT EDUKATIVO- ARSIMOR PËR ARSIM GJITHËPËRFSHIRËS					
	<i>Institucioni organizata përgjegjëse</i>	<i>Partnerët</i>	<i>Afatet Kohore</i>	<i>Burimet e financimit</i>	<i>Treguesit [Indikatorët]</i>	<i>Mekanizmat e vlerësimit</i>
Hapat e veprimeve: Hapja e studimeve MASTER për arsim Gjithëpërfshirës (AGJ) në FE	UP FE	MASHT	2010-2011	UP /MASHT 125.500 €	*Departamenti i hapur *Numri i studenteve te regjistruar	UP
Përfshirja e numrit të caktuar të lëndëve nga AGJ në programin bazë të përgatitjes së mësimdhënësve	FE	UP MASHT	2010 -2011	UP 11.040 €	*Programi i hartuar *Numri i lëndëve të përfshira në plan- program	UP
Trajnimi i motrave edukatore, edukatoreve, mësimdhënësve, personelit profesional për gjithëpërfshirje (në nivel bazik)	MASHT DKA	OJQ Donatorët QB	2010 në vazhdim	MASHT OJQ DKA 12.250 €	Numri i edukatoreve dhe mësimdhënësve të trajnuara	MASHT DKA
Zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe personelit edukativo- arsimor	MASHT DKA	OJQ	2010 në vazhdim	MASHT DKA 77.125 €	Numri i mësimdhënësve të përfshirë në zhvillimin profesional	MASHT

Trajnimi i drejtorëve komunal të arsimit dhe drejtorëve të shkollave	MASHT DKA	Agjensionet	Gusht 2010	MASHT DKA 1.500 €	Numri i trajnimeve	MASHT DKA
Organizimi i seminareve për personelin e MASHT	MASHT MIUJ	Agjensionet	Maj 2010-	MASHT MIUJ	Numri i seminareve	MASHT MIUJ
Organizimi i konferencave në nivel të vendit, rajonit dhe ndërkombëtare për arsimin gjithëpërfshirës	MASHT DKA	Agjensionet	Dhjetor 2010- 2015	MASHT MIUJ Donatorë 30.000 €	Numri i konferencave	MASHT DKA Agjensionet
Trajnimi i mësimeve udhëtues dhe gjithëpërfshirës	MASHT DKA	Agjensionet	Shtator - 2010	MASHT DKA Donatorë	Numri i mësimeve të trajnuar	MASHT DKA Ekspert të jashtëm

OBJEKTIVI 4 :	PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE PËR SHKOLLËN GJITHËPËRFSHIRËSE					
	===== Hapat e veprimeve:	<i>Institucioni organizata përgjegjëse</i>	<i>Partnerët</i>	<i>Afatet Kohore</i>	<i>Burimet e financimit</i>	<i>Treguesit [Indikatorët]</i>
Ndërtimi i objekteve shkollore duke respektuar standardet për gjithëpërfshirje	MASHT DKA	Agjensionet	Proces	MASHT DKA BB	Numri i shkollave të ndërtuara sipas standardeve	MASHT DKA
Renovimi i shkollave për gjithëpërfshirje (ndërtimi i pjerrinave dhe tualeteve speciale për qasje në shkolla, pajisja me inventar adekuat etj sipas standardeve evropiane)	MASHT DKA	Donatorë Komuniteti	Në proces	MASHT Donatorë Komuniteti	Numri i shkollave të adaptuara sipas standardeve	DKA MASHT
Pajisja e dhomave të burimeve me mjete adekuate	DKA MASHT	MASHT OJQ Donatorë	Ne proces	DKA MASHT	Dhomat të pajisura me mjete adekuate	DKA MASHT
Rregullimi i hapësirave jashtë shkollës që mundësojnë qasje sipas standardeve	MASHT DKA	Donatorë OJQ Komuniteti	2011-2013	MASHT DKA Donatorë	Numri i shkollave që i plotëson standardet për qasje horizontale Numri i fëmijëve	MASHT DKA
Organizimi i transportit të	DKA	Donatorë	2010-2011	DKA	Numri i fëmijëve me aftësi të	DKA

përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara				No budget?	kufizuara që e shfrytëzojnë transportin	
Organizimi i hapësirave të përshtatshme shkollore (klasa, njejve sanitare, salla sportive, biblioteka, kabinetet dhe sigurimi i inventarit të përshtatshëm) për fëmijët me aftësi të kufizuara	MASHT DKA Shkolla	Donatorë	2010-2014	DKA MASHT Donatorë 400.000 €	Numri i shkollave sipas standardeve	MASHT DKA

OBJEKTIVI 5: =====	NGRITJA E VETËDIJES E GJITHËPËRFSHIRËSE					
	<i>Institucioni/ organizata përgjegjëse</i>	<i>Partnerët</i>	<i>Afatet Kohore</i>	<i>Burimet e financimit</i>	<i>Treguesit [Indikatorët]</i>	<i>Mekanizmat e vlerësimit</i>
Hapat e veprimeve:						
Organizmi i debateve, seminareve, konferencave rajonale dhe ndërkombëtare për AGJ	MASHT DKA Shkolla IP	OJQ SHPA Donatorë	2010 2014	MASHT DKA Donatorët 30.000 €	Numri i konferencave të organizuara	Pjesëmarrësit
Organizimi i fushatave për vetëdijesim mbi arsimin gjithëpërfshirës	MASHT	DKA OJQ SHPA Donatorë USHPAK	2010 2015	MASHT Donatoret 14.000 €	Fletushkat Broshurat Emisionet kontaktues media	MASHT
Ngritja e kapaciteteve të stafit të institucioneve vendimmarrëse	MASHT		2010 2012	MASHT Donatoret 300 €	Cilësia në punë	MASHT
Fuqizimi dhe funktionalizimi i rolit të KPAK	MASHT DKA KPAK Shkolla	DKA KPA Shkolla Donatorë	2010	MASHT Donatoret DKA	Numri i takimeve të mbajtura	MASHT

FJALOR TERMINOLOGJIK

Fëmija me nevoja të veçanta arsimore – Fëmija me nevoja të veçanta arsimore është ai fëmijë i cili ka vështirësi të theksuara në të nxënë në krahasim me bashkëmoshatarët e tij dhe i nevojitet mbështetje e veçantë. Kjo mbështetje duhet të jetë në formë të organizuar dhe zyrtare dhe duhet të ofrohet sa më tepër që është e mundur në mjedise të integruara në shkolla të rregullta. Ekipi komunal vlerësues dhe mbështetës përcakton se cilët fëmijë kanë nevoja të veçanta arsimore. Të gjithë fëmijët që janë përcaktuar se kanë nevoja të veçanta arsimore dhe kanë vendimin për arsim me nevoja të veçanta duhet të kenë Plan Individual të Arsimit.

Klasa e bashkangjitur – është klasë e cila funksionon në shkollë të rregullt dhe aty mësojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Në këto klasë janë të vendosur fëmijë që kanë nevoja të veçanta arsimore të ndryshme, kanë dëmtime të ndryshme dhe janë të moshave të ndryshme. Në këto klasa punojnë arsimtarë që janë të trajnuar për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Këto klasa momentalisht janë mjaft të mbyllura, që do të thotë se fëmijët që janë aty i vijnë mësimet ndaras nga bashkëmoshatarët e tyre të rregullt.

Kur janë themeluar në fillim këto klasë është menduar që të jenë si mundësi për të rritur përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Është planifikuar që fëmijët të qëndrojnë aty për një kohë të shkurtë deri sa të përshtaten dhe pastaj të integrohen në klasa të rregullta. Mirëpo ka kaluar shumë kohë dhe akoma fëmijët nëpër këto klasa janë aty. Një numër shumë i vogël i këtyre fëmijëve është integruar në klasa të rregullta. Në fakt ka ndodhur e kundërta, fëmijët janë lëvizur nga klasat e rregullta në këto klasa. Kur janë themeluar këto klasa është menduar gjithashtu që të jenë më të hapura, që sa më shumë që është e mundur fëmijët të ndjekin mësimet në lëndë të caktuara me bashkëmoshatarët e rregullt. Kjo nuk ka ndodhur apo ndodh shumë pak. Kjo formë e funksionimit jo të mirë të këtyre klasave është parë edhe nga hulumtimi⁹ i bërë nga Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Në të ardhmen parashihet që këto klasa të transformohen në dhoma të burimeve, dhe shumica e fëmijëve të kalojnë nëpër klasa të rregullta deh arsimtarët që kanë punuar me këto klasa të mbështesin këta nxënës nëpër klasa të rregullta.

Klasat e bashkangjitura në të ardhmen do të funksionojnë vetëm për grupet e fëmijëve të shurdhër dhe fëmijët me dëmtime të rënda.

Arsimi special – Proces mësimor i planifikuar për të plotësuar nevojat mësimore në përputhje me zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Arsimi special është zhvilluar si sistem i ndarë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, në bazë të supozimit se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore kanë nevojat të tilla që nuk mund të përfitojnë nga mësimdhënie e cila organizohet në shkollat e rregullta.

Shkollat speciale / Qendra Burimore - Këto janë shkolla ku ndjekin mësimet fëmijët me aftësi të kufizuara të ndryshme dhe ato janë të organizuara në bazën e llojit të dëmtimit.

⁹ Marrë nga raporti i hulumtimit i bërë nga Instituti pedagogjik i Kosovës: *Klasat e bashkangjitura mundësi integrimi apo segregimi për fëmijët me nevoja të veçanta*, Prishtinë 2008

Ekzistojnë 7 shkolla speciale: Shkolla për fëmijët me dëmtime në të parë në Pejë, shkolla për fëmijët me dëmtime në të dëgjuar në Prizren, shkollat për fëmijët me dëmtime intelektuale në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe në Shtime. Ekziston edhe një shkollë speciale në veriun e Mitrovicës ku vijojnë fëmijët serbë e cila nuk është e integruar në sistemin e MASHT-it dhe nuk ka informata të mjaftueshme për të. Këto shkolla janë mjaft të shtrenjta dhe shërbejnë një numër shumë të vogël nxënësish. Në vitin 2006, me ndihmën e FSDEK (Përkrahja finlandeze për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë) ka filluar transformimi i këtyre shkollave në Qendra Burimore. Dmth. kalimi nga shkollë e mbyllur në shkollë më të hapur. Ky proces i transformimit akoma nuk ka përfunduar dhe ka si synim që stafi i shkollave speciale të mos shërbejë vetëm për fëmijët që ndjekin mësimet në shkollë, por të ofrojë mbështetje edhe për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore që janë në shkolla të rregullta.

Transformimi i këtyre shkollave është planifikuar të jetë i tillë që të shërbejë si Qendër Burimore e cila do të ketë dy njësi: Njësinë e shkollës speciale e cila do të organizon dhe zbaton mësimdhënien për fëmijët që kanë aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta dhe njësinë apo qendrën e shërbimeve të mbështetjes e cila do të mbështet fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimtarët e tyre në shkolla të rregullta.

Planifikohet që në të ardhmen të bëhet riorganizimi i brendshëm i qendrave burimore ashtu që më tepër staf të kalojë në njësinë apo qendrën e shërbimeve të mbështetjes. Po ashtu, planifikohet që të punësohet staf i ri në qendrat burimore për të rritur kapacitetet e qendrave të shërbimeve të mbështetjes brenda qendrave burimore për të mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta.

Arsimi gjithëpërfshirës – është qasje e re në arsim ku të gjithë fëmijët mësojnë së bashku në shkollën më të afërt të rregullt. Pra, të gjithë fëmijët, pa dallim race, gjinie, etnie apo aftësie të kufizuara apo ndonjë dallim tjetër kanë të drejtë për arsim në shkollën e rregullt më të afërt. Arsimi gjithëpërfshirës nuk nënkupton vetëm vendosjen e fëmijës në shkollë por edhe organizimin e mbështetjes efikase sipas nevojave individuale të fëmijëve.

Shkolla gjithëpërfshirëse - është institucion shkollor i cili pranon të gjithë fëmijët pa marrë parasysh dallimet që mund të kenë. Shkollat që kanë orientim gjithëpërfshirës bëjnë të gjitha ndryshimet e nevojshme si fizike ashtu edhe në aspektin e qëndrimeve për të akomoduar lloje të ndryshme të fëmijëve dhe për të organizuar sisteme efikas të mbështetjes për fëmijët që kanë pengesa në të nxënë.

Fëmija me aftësi të kufizuara – është term i përgjithshëm i përdorur për kufizime funksionale, që shkaktojnë pengese në aftësinë e një personi, për shembull, për të ecur, për të ngritur, shërbyer, ose për të mësuar. Kurse Mund të referohet po ashtu një gjendje fizike, dëgjimore ose mentale. Ky është një rezultat i procesit të aftësisë së kufizuar, i cili ndodh kur fëmijët me dëmtime përjetojnë barriera në pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri.

Mësimdhënës udhëtues - Janë arsimtarë të cilët janë të punësuar në shkolla speciale/qendra burimore të cilët mbështesin nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimtarët e tyre në shkollat e rregullta.

Plani individual i arsimit - PIA – Plani individual i arsimit [PIA] është dokument zyrtar pedagogjik i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme zhvillimore ka marrë vendimin për edukim dhe arsimim me nevoja të veçanta. Plani Individual i Arsimit shërben për planifikimin sistematik të edukimit, mësimdhënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës në mësim. Të gjithë fëmijët të cilët kanë vendim mbi arsimin me nevoja të veçanta duhet të kenë PIA.

Ekipet bërthamë – janë grupet të formuara nga stafi ekzistues i shkollave speciale/qendrave burimore dhe detyrë e tyre është ndërtimi i shërbimeve të mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta dhe arsimtarët e tyre. Këto grupe kanë për detyrë që të koordinojnë gjithë procesin e shndërrimit nga shkolla speciale e tipit të mbyllur në qendër burimore dhe ndërtimit të sistemit mbështetës për arsim gjithëpërfshirës.

Ekipet vlerësuese mbështetëse – Këto ekipe planifikohen të ndërtohen në nivelin komunal dhe janë ekipe të përbëra prej profesionistëve të cilët do të bëjnë vlerësim profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, do të marrin vendimin për arsim me nevoja të veçanta, do të propozojnë se ku do të vendoset fëmija dhe japin rekomandime për mbështetjen arsimore që duhet të ketë fëmija. Vlerësimi bazohet në fuqitë dhe aftësitë e nxënësve, dhe raportet nga vlerësimi duhet të jenë më tepër me fjalor pedagogjik që u hyn në funksion arsimtarëve dhe stafit tjetër arsimor që punon me fëmijën e jo raport mjekësor.

REREFENCA

FSDEK (2003). *Edukimi Special në Kosovë.* GME

IPK (2008). *Klasat e bashkangjitura mundësi integrimi apo segregimi për fëmijët me nevoja të veçanta.* Raport hulumtimi.

MASHT/EMIS (2010). *Statistikat e Arsimit në Kosovë.* 2009-2010.

MASHT (2007). *Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007-2017.*

R. e Kosovës (2009). *Plan kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara i Republikës së Kosovës 2009-2011.*

SHTOJCE 1

Buxheti sipas viteve :

2010	2011	2012	2013	2014	2015
€ 111.342	€ 833.015	€ 1.107.629	€ 1.220.409	€ 1.801.535	€ 1.981.944